



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 78

Prishtinë, më 20 maj 2013, në orën 12:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N 302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Behar Selimi, Ardian Gjini, Haki Demolli, Halit Krasniqi, Gëzim Kelmendi, Arsim Bajrami, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj dhe Jasmina Zhivković.

Munguan: Arben Gashi dhe Mufera Shinik.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Hasan Preteni, Afrim Atashi dhe Blerim Kelmendi - AKK; Etleva Ikonja – Kosova Sot; Besian Bicurri KDI/TIK; Isuf Zejna – KDI; Fidan Rama – TRIBUNA; Arton Demhasaj – Çohu; Shkodran Gajraku- Klan Kosova; Artan Canhasi – EULEX; Bardha Shkreli – RTK; Elvis Feka – Kosova Think Tank; Teuta Gashi- Kosova Press; Rebeka Maliqi dhe Burbuqe Berisha – praktikantë.

Nga Stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Behar Selimi, nënkryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.4.2013;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2012;
4. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit;
5. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë;
6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 15.04.2013

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 15.04.2013, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2012

Hasan Preteni – Në fjalën e tij para deputetëve, paraqiti raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2012. Ai tha se kjo agjenci ka një përparim të vogël, sa i përket kallëzimeve penale, numri i të cilave është rritur. Po ashtu, ka një bashkëpunim të madh me prokuroritë vendore dhe raporte shumë të ngushta me EULEX-in. Po ashtu, kjo Agjenci ka një bashkëpunim shumë të mirë me Këshillin Prokurorial, me prokurorin e EULEX-it. Shumica e rasteve të publikuara për ngritje aktakuzash ose publikim, që janë duke u zhvilluar hetime penale, zanafillën e kanë në Agjenci. Theksoi se sa i përket gjykatave, kemi vetëm një rast që kemi informacionin nga Prokuroria në marsin e vitit 2008 dhe ende nuk kemi njohuri se çka është duke ndodhur me këtë rast. Karakteristikat gjatë hetimeve paraprake kanë të bëjnë me veprën penale, shpërdorim i detyrës zyrtare apo autorizimit, neni 339 të Kodit Penal. Shkeljet parashihi nga përgatitja e tenderëve. Në luftën kundër korrupsionit kemi një progres, por mbetet shumë për t'u dëshiruar. Agjencia mbledh shënime dhe të dhëna edhe nga institucionet e tjera, të cilat i analizon dhe i publikon. Në këtë periudhë mund të themi se kemi më shumë se 50 zyrtarë të lartë që ndaj tyre ose është ngritur aktakuzë, ose janë bërë publike hetimet penale. Janë 8 kryetarë të komunave për të cilët është ngritur aktakuzë, kemi rreth 20 zyrtarë qeveritarë, kundër të cilëve është ngritur aktakuzë. Në vitin e kaluar prokuroritë kanë ushtruar 140 propozim- akuza dhe 132 aktakuza. Për ata të cilët nuk e kanë bërë deklarin pasurisë gjykatat i kanë lehtësuar procedurat për kundërvajtje dhe i kanë trajtuar për deklarin jo të rregullt dhe se gjykatat po i neglizhojnë në tërësi pas përfundimit të detyrës zyrtare. Çdo i 8-ti formular mund të themi se është problematik dhe na janë paraqitur shumë probleme, ngase duke analizuar formularët që janë deklaruar në vitin 2008 e deri më tani, ka mospërputhje në mes të hyrave dhe pasurisë që krijohet. Një specifikë e këtij raporti, është një analizë e deklarinimit të pasurisë së zyrtarëve nga vitit 2008 e deri në vitin 2010, ato nuk janë bërë publike. Ai theksoi se brenda kësaj periudhe kemi disa zyrtarë të cilët kanë arritur të jenë milionerë, tek vendet e punës kemi 69 zyrtarë të cilët ushtrojnë më shumë se 2 detyra, gjë që nuk lejohet ligjërisht. Tek konflikti i interesit, kemi një menaxhim të mirë. Vendimet janë bërë publike dhe kemi 2 raste të dy punëtorëve, të cilët nuk i janë shmangur konfliktit të interesit dhe se emrat e tyre janë bërë publik dhe i kemi dërguar në gjykatë dhe kemi kërkuar shkarkimin e këtyre udhëheqësve. Te parandalimi i korrupsionit, kemi një aktivitet pozitiv dhe jemi duke i përcjellë publikimet e tenderëve të cilët bëhen në Komisionin Rregullativ të Prokurimi Publik, në të gjitha rastet ku

kemi vërejtur se kemi kundërshtime me ligjin. Opinionet tona janë pranuar, me përjashtim të një rasti. Agjencisë iu lejua punësimi edhe i 5 zyrtarëve për parandalimin e korrupsionit. Buxhetin e kemi shpenzuar rreth 93 %, ky raport u pranua nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Ardian Gjini – Tha se Agjencia Kundër Korrupsionit, nuk duhet të jetë vetëm agjenci e cila merret me grumbullimin e të dhënave të deklarimit të pasurisë të zyrtarëve të lartë. Luftimi i korrupsionit duhet të bëhet në atë mënyrë, duke filluar nga ata persona të cilët janë korruptuar dhe ata të cilët nuk e deklarojnë pasurinë. Me këta persona duhet të merren prokuroritë dhe gjykatat. Cilat ligje dhe cilat norma duhet ndryshuar, gjë që shkaku i kësaj Kosova ka dështuar kur e dimë që ka zyrtarë të lartë politikë që e rrisin pasurinë me miliona. Kishte një kërkesë nga Agjencia Kundër Korrupsionit që të bëjë më tepër sa i përket luftimit të korrupsionit.

Albulena Haxhiu – Tha se ky është një raport i mangët dhe i gjymtuar. Në këtë raport shihet se Agjencia Kundër Korrupsionit nuk është efikase në luftimin e korrupsionit, por po merret më shumë me përshkrimin e detyrave dhe buxhetit, sesa me ato detyra që i ka. Kemi një shpërpushje enorme në mes të hetimeve të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe atyre që i fillon prokuroria. Mbi 50 % të rasteve që Agjencia i konsideron raste korrupsioni, prokuroria i hedh poshtë, dhe ky fenomen vazhdon prej vitit 2006. Më intereson pse ekziston kjo shpërpushje, a janë këto raste të mosprofesionalizmit apo të dorës së padukshme të pushtetit. Do të ndërlihem tek rastet e interesit që ju i cekët, kemi Slobodan Petroviqin që ishte ministër i Pushtetit Lokal dhe zëvendëskryeministër në deklarimin e pasurisë së tij. Ai deklaroi që në vitin 2011 është emëruar si ministër dhe zv. kryeministër, ndërsa që nga vitit 2008 ka qenë anëtar i Bordit të AKP-se. Pra, ju keni lejuar që një zyrtar i lartë të ketë dy pozita shumë të rëndësishme dhe rasti tjetër është për z. Gjoshi në KQZ, që ju e keni cilësuar si veprimtari private punën në KQZ dhe keni thënë se është një gabim teknik dhe jeni bazuar në disa të dhëna të pavërteta të tij, ndërsa i njëjti merr gjysmën e pagës në KQZ dhe merr të gjitha benefitet. Po ashtu, ka mandat të plotë dhe merr pjesë në të gjitha mbledhjet e KQZ-së. Pyetja ime është: A i keni përcjellë ju të gjitha proceset e tenderimit në Qeveri dhe a janë ato të rregullta sipas jush dhe cila është mungesa e opinionëve për këtë nivel qeverisës? Nuk mund të votojmë pro këtij raporti as në këtë Komision, e as në Seancë plenare, sepse është një raport mjaft i mangët.

Halit Krasniqi – Sa i përket raportit, theksoi se është një raport pozitiv dhe mjaft profesional, i cili do ta këtë mbështetjen e anëtarëve të Grupit Parlamentar të PDK-së. Ky raport mbetet të plotësohet në të ardhmen edhe në aspektet e tjera. Ai tha se kjo Agjenci e ka mandatin e kufizuar dhe se gjykatat nuk mund të bëhen qysh kërkon opinioni.

Haki Demolli – Në fjalën e tij tha se nuk është i kënaqur me luftimin e korrupsionit, si në cilësinë e deputetit, po ashtu edhe të qytetarit. Ai tha se kjo Qeveri ka deklaruar se do t'i shpallin 0 tolerancë korrupsionit, kurse praktika ka treguar diçka tjetër, ku korrupsioni ka kapluar Qeverinë, ministrinë etj. Që do të thotë se ky vend është i rrezikuar nga vet korrupsioni dhe është ndër vendet më të korruptuara në Evropë. Mirëpo, sa i përket punës së Agjencisë, tha se është i kënaqur me mënyrën e mbledhjes së të dhënave, mënyrën se si i sistemon ato, klasifikohen dhe paraqiten si vepër penale. Një pyetje do ta parashtrojë në fund se si institucioni

për luftimin e korrupsionit, siç është prokuroria, nuk kanë ndonjë raport të mirëfilltë në Agjencinë Kundër Korrupsionit. Një çështje tjetër që përmendet në raport, është strategjia e vitit 2013-2017. Ne si Grup Parlamentar i LDK- së ishim kundër kësaj strategjie, jo pse nuk dëshirojmë që të luftohet korrupsioni, mirëpo këto strategji deri me tani nuk kanë treguar ndonjë sukses, dhe nuk po analizohen pas përfundimit të tyre, që të shihen rezultatet konkrete. Sa i përket deklarimit të pasurisë së disa zyrtarëve që janë të obliguar të bëjnë deklarimin e pasurisë së tyre nuk e kanë bërë dhe ndaj tyre ngrihet procedurë administrative dhe ata marrin disa dënime qesharake. A kemi ndonjë deklarim të dhuratave që është në këtë raport në f. 25 ndonjë banesë e dhuruar, veturë apo vetëm ato dhurata simbolike që nuk çojnë peshë. Më intereson të di për ata milionerë të cekur nga drejtori, pse emrat e tyre të mos bëhen publikë, dhe cilat veprime i ka ndërmarrë Agjencia Kundër Korrupsionit për ta vërtetuar origjinën e pasurisë së tyre? Raportimet e mediave që janë të pacensuruara dhe raportojnë për shumë detaje, sa shfrytëzohen si material pune për Agjencinë e juaj, që vetëm gjatë vitit 2012, kanë qenë 202 shkrime për korrupsion. Dhe krejt në fund, kam një pyetje: Cili është raporti i AKK- së me Prokurorinë e Shtetit, a ka pasur ndonjë takim për të diskutuar për çështjen e paraqitjeve dhe cila është përgjigja e tyre për mospërfillje të raportit që vjen nga Agjencia?

Armend Zemaj – Tha se korrupsioni jo vetëm që ka një rritje të theksuar, por kemi shënuar edhe regres në luftimin e kësaj dukurie në të gjitha nivelet. Sa i përket raportit, pavarësisht që një raport duhet të përshkruhet me detyrat dhe punët që janë bërë dhe vlerësimi nuk është me atë që e vlerësojmë ne si raport të shkruar, pra atë që është paraqitur me përkushtim edhe në bazë të ligjit. Unë mendoj që këtij raporti i mungojnë sfidat dhe i mungojnë ato se me çka duhet të përballlet vetë Agjencia, por edhe shoqëria në tërësi, duke filluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe organet tjera, që janë të thirrura për ta luftuar krimin. Këtë po e ilustruj jo vetëm me këto fakte që i thanë edhe koleget e mi deputetë, por edhe me fakte tjera që ne hasim për çdo ditë, sidomos në institucionet e Republikës së Kosovës, duke filluar nga ekzekutivi që është e para që ndeshet me korrupsionin, por edhe te gjykatat dhe prokuroria, nuk do koment tjetër që te gjykatat dhe prokuroria shihet pjesa e fundit e deklarimit të zyrtarëve, kemi dënime të çuditshme në kundërshtim me ligjin, për ata që e kanë deklaruar pasurinë dhe kjo do të ishte një ndër pyetjet e mia se a keni shqyrtuar ju këtë çështje dhe a mendoni që aty ka konflikt interesi. Unë mund t'ju them se nga raporti edhe ata që i njoftim me emra në komuna të ndryshme ose në ministri, që kanë lidhje me gjykatat, shihet që ose ka dënim 50€, dënim qesharak, ose shikoni ju edhe në bazë të mbiemrave ose lidhjeve që i kanë, ekzistojnë lidhjet korruptive në mes të këtyre njerëzve të ashtuquajtur të fortë. Këtë nuk po e them pa fakte dhe po më intereson se cila është iniciativa juaj në raport, pra në këtë që ju keni paraqitur. Këtu shihet qartë, edhe pse raporti është i zbehtë që gjykata dhe prokuroria nuk e luftojnë korrupsionin. Pse po e them këtë? Te deklarimi i pasurisë keni zyrtarë të lartë, ku Albulena e apostrofoi një zëvendëskryeministër për konflikt interesi dhe mbajtës i 2-3 detyrave apo paraqitjes së rrejshme të pasurisë. Ne kemi haptas njerëz që nga viti në vit, shikojeni janë publike, thonë në vitin 2001 blerjen e banesës në Prishtinë 100,000€ dhe në anën tjetër ka deklarimin zyrtar ku thotë nga kursimet në Zvicër, kurse thotë që kurrë nuk ka punuar në Zvicër, vetëm me social kam jetuar. Këtu tregon që kemi drejtpërdrejt njerëz të korruptuar, të cilët kanë keqpërdor edhe fondet e popullit, edhe paratë e luftës dhe vazhdojnë ta keqpërdorin buxhetin e Republikës së Kosovës, komandantë, zyrtarë, politikanë me emra dhe mbiemra. Kjo është ajo që duhet të jetë sfida e këtij raporti dhe sfida e shoqërisë.

Ka kryetar të komunave, që po t'u shihet pasuria ku kanë biznese të evidentuara nga ju dhe nga prokuroria, si dhe nga gjykatat, kanë shtëpi milionëshe dhe i ikin drejtësisë, ku çuditën edhe qytetarët e vendit me këtë pasuri të krijuar nga taksat e varfra të qytetarëve. Ju keni deklaruar që 6-7 zyrtarë të lartë i mbajnë ka 5-6 pozita. E thatë edhe vetë, 269 zyrtarë mbajnë më shumë se 2 pozita. Pra, rasti i fundit për një zyrtar të lartë për një pozitë që u kualifikua si pozitë private, po e jep betimin para presidentes së Republikës së Kosovës. Ajo na ka shqetësuar të gjithëve. Për ilustrim, shikoni në Kuvend të Kosovës pas orës 12 sa mungojnë dhe ata marrin paga tjera nga buxheti i Republikës së Kosovës. Unë kam problemin me prokurorinë dhe gjykatat, si dhe policinë për krime ekonomike dhe këtu do të doja të ishit më konkret dhe t'ju tregoni qytetarëve të vendit për sfidat e sakta tuajat me ata. Mendoj se çështjet e legjislacionit duhet të ulemi dhe t'i shqyrtojmë bashkërisht si komision kompetent, që këtij raporti i mungon ligji mbi konfliktin e interesit dhe ligjet tjera që ka të bëjë me ndërmarrjet publike, pra aty ku është gangrena më e madhe e buxhetit të Kosovës. Unë po e theksoi edhe para Komisionit dhe kolegëve deputetë, që nuk ka vullnet nga shumica për ta luftuar këtë dukuri. Kjo është paraqitur edhe me fakte dhe do ta them edhe në Seancë plenare.

Gëzim Kelmendi— Padyshim, tema e sotme që ka të bëjë me korrupsionin, na jep një imazh të keq, ku fatkeqësisht përmasat e korrupsionit vazhdimisht janë në rritje. Sa i përket raportit apo konkretisht Agjencisë Kundër Korrupsionit, nuk e bëjnë në plotni apo si duhet punën e tyre, sepse ne e dimë që një institucion, qoftë në nivel lokal apo qendror, nuk është i përkryer dhe çdokush që punon ka mangësi në punë. Atë që e kam thënë edhe në Seancë plenare, po e them edhe këtu, që kapacitetet e Agjencisë nuk janë të mjaftueshme për ta luftuar korrupsionin. Ne e dimë që kohë më parë është formuar edhe Këshilli Kombëtar, i iniciuar nga presidentja, pikërisht për luftimin e korrupsionit, dhe qysh në fillim, është i formuar për të dështuar. Këtë e them publikisht për faktin se korrupsioni nuk është prezent vetëm në Qeveri apo në nivelin komunal, por fatkeqësisht korrupsionin e kemi në të gjitha shtresat e shoqërisë. Tash kemi edhe avokatë dhe prokurorë për përfitime materiale shumë më të mëdha se në profesionin e tyre si avokat. Ka edhe shumë shtresa tjera publike, si shëndetësia arsimi, administrata, të gjitha janë të prekura nga korrupsioni. Fatkeqësia më e madhe është që edhe qytetarët janë shumë aktiv për të arritur qëllimet e tyre, të cilët ofrojnë dhe bëhen pjesë e korrupsionit me vetë dëshirën e tyre. Edhe një informatë për Agjencinë. Besoj që edhe këta e dinë që fitimet e pasurisë pas luftës në mënyrë të paligjshme po bëhet shpëlarja e atyre parave nëpërmes bastoreve sportive. Pyetje ime konkrete është: A keni ndonjë mekanizëm që ta verifikoni që një zyrtar i lartë publik ka deklaruar pasurinë e tillë dhe ajo nuk është reale, cilët janë hapat e juaj konkretë që ta zbuloni?

Halit Krasniqi—Jam i obliguar që të plotësojë në disa aspekte fjalët e mëparshme, pasi që u shfrytëzua momenti i koncentrimit të mediave në raportin e Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe kishte edhe vlerësime joprofesionale, të cilat kanë konotacione në publik dhe krijon amogami konstruktesh. Grupi Parlamentar i PDK-së, jashtëzakonisht me shqetësim, e ka trajtuar fenomenin dhe dukurinë e korrupsionit, ndërsa shumë herë iu keni bërë gjyq ministrave tanë, ndonjëherë kur keni vërejtur se ka ndonjë lëshim ose problem që e kemi parë të arsyeshme për ta ngritur. Në mesin e zyrtarëve tanë kemi pasur edhe deputetë, të cilët kanë qenë në listën e milionerëve të kualifikuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit, por për publikun dhe kolegët e mi, këtu dua të paraqesë një të dhënë telegrafisht që pasuria ime është në breza e fituar deri në

momentin kur kanë deklaruar dhe natyrisht se ajo kalon 1,500,000€, por nuk është rezultat i punës sime, as i fitimeve të mia, por të njëjtën mënyrë e kanë edhe zyrtarë tjerë të PDK-së, që janë kualifikuar si milionerë dhe pjesa dërmuese e kanë trashëgimi në breza dhe kjo ka krijuar pakënaqësi. Vërtet, siç e apostrofoi kolegu, këtu e kemi dëgjuar kryeministrin ku thotë se do të kemi zero tolerancë ndaj korrupsionit. Është e vërtetë që kjo është mirëpritur në Grupin Parlamentar të PDK-së dhe kemi inkurajuar që të vazhdojë me këto pika. Është e vërtetë që lufta ndaj korrupsionit mund të jetë observuar dhe një perceptim në publik ka shënuar një regres dhe një rënie. Ishte edhe një konstatim që thotë se nuk ka vullnet politik për ta luftuar korrupsionin. Ky është një konstatim joprofesional. Këtu nuk është vendi për ta trajtuar këtë çështje. Unë mund të konfirmoj si përfaqësues i PDK-së, bashkë me kolegun Behar Selimi, që në grupin tonë parlamentar, jashtëzakonisht shumë herë e kemi trajtuar këtë fenomen. Unë do të përmend disa raste, madje edhe nga deputetë të PDK-së në Seancë plenare edhe për fenomenin e lojërave të fatit dhe kemi kërkuar që këtë fenomen duhet ta trajtojnë institucionet e Kosovës. Unë mund t'i siguroj kolegët deputetë, që në grupin tonë parlamentar ka ndoshta që jo të gjithë që janë pa kompromis për luftën kundër korrupsionit.

Haki Demolli—Pa dashur që të dal jashtë raportit, pa dashur të replikoj me kolegun Krasniqi, kisha dashur ta shtroj edhe një pyetje për Agjencinë Kundër Korrupsionit: A janë bërë milionerë në saje të punës së brezave të mëparshëm? Unë personalisht për kolegun Krasniqi nuk dyshoj për këtë, vetëm dua të theksoj se Kosova është një vend i vogël dhe ka më pak se 2.000.000 banorë dhe pothuajse të gjithë e njohim njëri-tjetrin dhe për shumicën e dimë se çka kanë pasur para luftës dhe çfarë vetura kanë vozitur, çfarë biçikletash kanë vozitur dhe me çka kanë ardhur deri ne Prishtinë, ndërsa për një periudhë shumë të shkurtër janë bërë milionerë. Unë e di që me rrogë dhe fitim të ndershëm është pak si vështirë. Nuk mund të themi që partia jonë i ka pasur paraardhësit milionerë, se ne e dimë se prej nga vjen partia jonë. Shumica janë bërë me korrupsion, me keqpërdorime, me tenderë të ndryshëm me përqindje 10-15 e 20%, sepse milioni është vështirë të bëhet në vendet e varfra, siç është Kosova. Çështja tjetër, zero tolerancë, kjo ka qene më shumë e karakterit deklarativ, sepse përkundrazi kolegët, bashkëpunëtorët në pozita të ndryshme komunale, që ju e dini që tani kemi 7 udhëheqës të komunave të ndjekur penalisht, pikërisht për natyrën e tillë ekonomike korruptive dhe është një numër i ministrave që thonë se do t'i ndjekë EULEX-i, përkundrazi jo që e kanë luftuar, por kanë dhënë një kontribut të madh në zhvillimin dhe forcimin e korrupsionit, madje i kanë dobësuar edhe segmentet që duhet të jenë kundër korrupsionit, si policia, prokuroria gjyqësia, sepse në Kosovë mund të dënohet ai që vjedh një qerre me dru, e nuk dënohet dikush që vjedh milionat. Edhe një pyetje: Sa kallëzime penale i keni bërë për gjykatësit dhe prokurorët dhe policët e krimeve ekonomike, sepse këto janë tri hallkat kryesore, përfshirë edhe Agjencinë Kundër Korrupsionit? Edhe një gjë ta dimë, ai që është vetë i korruptuar, korrupsionin kurrë nuk do mund ta luftojë.

Albulena Haxhiu—Ne nuk kemi ardhur këtu për ta dëgjuar Halitin, se cili është vullneti i partisë në pushtet, sepse tash po duket vullneti i tyre ku korrupsioni veç po rritet, por kemi ardhur me për ta dëgjuar drejtorin e Agjencisë për raportin e tij. Ajo që tha Haliti, janë më shumë fraza moralizuese dhe as që dua të merrem. Por, dihet që qeveria e korruptuar nuk mund asnjëherë ta luftojë atë. Sa i përket disa çështjeve që u ngritën nga shoqëria civile më herët, unë vetëm po i citoj disa nene të Agjencisë, ku thuhet se Kuvendi, në bazë të ligjit dhe Rregullores së punës,

themelon komisionin mbikëqyrës të agjencisë dhe seanca ka një vendim që ai komision është Komisioni për Legjislacion dhe nuk thuhet në ligj që ne të kërkojmë nga ju që ju të sillni deklarin e pasurisë, sepse neni 14, pika 1.6, e ka si kompetencë të komisionit mbikëqyrës që kontrollon dhe mbikëqyrë pasurinë e zyrtarëve. Gjithashtu, ligji na jep neve mundësinë që të kërkojmë një raport shtesë. Në këtë raport kisha kërkuar që të sillni këtu emrat e atyre milionerëve, të cilët janë përmendur, meqë nuk i kemi dhe nga kureshtja po më intereson se kush e bën kontrollin paraprak para se të vijë në komision.

Armend Zemaj—Jo rrallë herë, kolegu Krasniqi ka pasur deklarime në Kuvendin e Kosovës që janë në shërbim për qytetarët e Kosovës, por dua t'i them që është një vullnet i tij, e jo i shokëve të tij dhe nuk po mund ta marrë përkrahjen e shokëve të tij, pra nga partia në pushtet, që ta luftojë këtë dukuri. Këtë mund ta ilustruj edhe me fakte se është e vërtetë që dikush ka trashëgimi, por ne kemi evidentuar që dikush e ka ndryshuar trasenë e autostradës, për ta qitur kah toka e vet për përfitime, por fatkeqësisht s'po mund ta luftojë as agjencia as prokuroria, as gjykatat. Unë e pata edhe një pyetje dhe i mungon raportit bashkëpunimi me auditorin gjeneral. Fatmirësisht, ato raporte janë publike dhe është një komision këtu që e bën mbikëqyrjen e financave dhe shpenzimeve publike. Në të vërtetë, ne e patëm ngritur edhe në Seancë plenare edhe nga raporti i auditorit gjeneral, që ishte aty nga një tender, një derë 5€ dhe nuk zgjati shumë plasi skandali i pasaportave, ku ishte vlera 1.400.000€, ndërsa ministri vazhdon të jetë në detyrë dhe me përkushtim e kryen detyrën e vet.

Arsim Bajrami - Kur flasim për raportet e kësaj Agjencie, duhet pasur parasysh një konsensus që është vetëm njëra prej hallkave në luftën kundër korrupsionit. Nganjëherë po krijohet përshtypja që krejt lufta apo ngecjet janë rezultat i kësaj Agjencie, ndërsa ne duhet ta dimë mirë mandatin ligjor të kësaj Agjencie, ndërsa jo vetëm që është një mandat i limituar, por ka për detyrë edhe ta hetojë korrupsionin. Në luftim të tij, janë disa institucione tjera, si gjykatat dhe prokuroritë. Gjithmonë prej Agjencisë ka dalë një konstatim se po hetohet dhe nuk po luftohet. Ne si Kuvend, kemi autoritet dhe jemi përgjegjës edhe për strategjitë e luftës kundër korrupsionit, si dhe të merremi me dy segmente, se sa po hetohet dhe a po hetohet bollshëm, a po hetohet në mënyrë gjithëpërfshirëse, a po arrestohet dikush nga ky hetim, sidomos a po hetohen anëtarët e Kuvendit, Qeverisë dhe përfaqësuesit tjerë të lartë shtetëror. Segmenti i dytë, sa i kemi gjykatat dhe prokuroritë efikase për ta luftuar këtë fenomen. Unë kam vetëm një pyetje që po e shohim që Agjencia ka nevojë për hetues dhe hulumtues të guximshëm dhe të pavarur. Pyetje për z. Preteni: A i keni plotësuar nevojat e brendshme të Agjencisë dhe a kanë stimulime këta njerëz që të punojnë ndershëm?

Behar Selimi – Tha se është shqetësuese çështja e korrupsionit dhe krimit të organizuar, që konsiderohen dy nga kërcënimet kryesore të sigurisë kombëtare dhe publike, andaj duhet të merremi mjaft seriozisht si shoqëri. Ai tha se ka pasur përpjekje edhe në instanca të tjera, po Kuvendi e ka rolin kryesor dhe Agjencia Kundër Korrupsionit është e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Nëse e shikojmë punën e Agjencisë karshi mandatit, ka dalë se ka bërë mjaft, por ne kërkojmë edhe më tepër. Drejtori e cekti se po hetohet mjaft pak dhe nuk po gjykohet fare. Edhe unë ashtu mendoj. Kemi probleme me agjencinë kompetente, me të cilën duhet luftuar korrupsionin. Nuk ka as edhe një kod penal në botë që mosdeklarimin e pasurisë e konsideron

vepër penale. Këtë e ka bërë Kuvendi i Kosovës, dhe natyrisht Ministria e Drejtësisë. Sa i përket raportit, mendoj se është një raport i pranueshëm. Kam një pyetje për drejtorin: A keni filluar me monitorimin dhe zbatimin e strategjisë, sidomos me atë që quhet plani i integritetit?

Hasan Preteni – Tha se është i vetëdijesohem për obligimet ligjore që i ka Agjencia, karshi Kuvendit dhe se është i gatshëm që të përgjigjet në të gjitha pyetjet e bëra. Sa i përket Ardian Gjinit, lidhur me pyetjen e deklarimit të pasurisë, ju siguroj që deklarimi i pasurisë dhe konflikti i interesit, janë në fazën e amendamentimit dhe kemi propozuar mjaft ndryshime. Sa i përket këtyre ligjeve, ka tendencë të ketë progres, por ka tendencë të ketë edhe regres, ka tendenca në zvogëlimin e transparencës që të zvogëlohen kompetencat e Agjencisë, karshi fushës së deklarimit të pasurisë. Mendoj që edhe shoqëria civile duhet të ketë hapësirë më të fuqishme dhe kompetencat e Agjencisë t'i sakrifikojnë edhe më shumë. Prof. Bajrami e potencoi që në ligj, Agjencia është organi qendror kundër korrupsionit. Është e pajustificueshme që gjyqësori mos të ketë të dhëna se sa raste i ka trajtuar, raportohet me numra, raportohet me raste, do të thotë ka rënie të gjykimit, nuk duhet gjatësia e dënimit të tyre. Legjislacionit i kemi propozuar, që tek konflikti i interesit që nuk ka qenë i rastësishëm publikimi i 869 emrave, tani është duke u amendametur ky ligj dhe ne kemi propozuar që zyrtarisht mos të jenë pjesë e universiteteve private. Nuk është problem paga, por mundësia potenciale e brendshme, konflikt interesi. Jemi të gatshëm që në çdo moment t'i plotësojmë kërkesat konkrete, por vetëm duke u mbështetur në mision. Dua të sqarojë vetëm një rast të prokurorisë, lidhur me kallëzimet penale. Nëse shkohet me provime të qëllimit, asnjë rast nuk do të gjykohej dhe do të liberalizohet korrupsioni në tërësi, d.m.th. mungon një vullnet i përgjithshëm i prokurorisë që t'i trajtojë rastet që kanë të bëjnë me korrupsionin. Sa i përket rastit të Petroviqit dhe të një deputeteje tjetër që e ka pasur të njëjtin status, atëherë ligjet bien ndesh me njëri- tjetrin. Konflikti i interesit thotë se nuk bën që një zyrtar, në të njëjtën kohë të ketë 2 pozicione vendimmarrëse. U përmend rasti i Betim Gjoshit, ju siguroj që pas intervenimit të mediave e kemi parë atë gabim. Betim Gjoshi nuk është në konflikt interesi dhe asnjë zyrtar tjetër në KQZ. Këto deklarime janë bërë nga kryetarja e KQZ-së. Në raport është paraqitur se kundër cilit institucion ka më shumë kallëzime penale, dhe në këtë vit, ka qenë Qeveria në rend të parë, ndërsa në vitin e kaluar kanë qenë ndërmarrjet publike me Qeverinë. Ju e dini që aktakuza nuk shkon me vite, nëse këtë vit kemi bërë kallëzimin penal. Strategjia nuk është e Agjencisë, agjencia me ligj përcakton punën rreth përpilimit të Agjencisë dhe raporton në Kuvend për zbatimin e saj. Janë 4 dokumente analizë e zbatimit të strategjisë së kaluar: plani i veprimit, vlerësimi i rrezikut, strategjia si dhe plani i veprimit. Sa u përket emrave të milionerëve, janë të publikuar. Kemi ofruar formularë nga viti 2008 deri në vitin 2010.

U përmend një banesë, e cila nuk guxon të pranohet nga zyrtarët. Ndër të tjera, Haki Demolli tha se a keni informata prej burimeve tjera se dikush po merr së paku një banesë. Kështu, ne po dëgjojmë si qytetarë. Një zyrtari tashmë iu ka konfiskuar një pasuri, i cili thotë se dy nga fëmijët e tij kanë në pronësi banesa prejardhja e të cilave është dhuratë. Në 2008, Agjencia i ka iniciuar disa raste dhe në këtë vit është ngritur aktakuza. Sa i përket kallëzimit penal, prokurorisë, policisë dhe gjykatave, në këtë vit nuk kemi pasur, ndërsa viteve të kaluara, ka pasur. Dënimet për mosdeklarim të pasurisë është çështje e gjyqësorit. Komunat e vogla po i neglizhojnë lëndët ose kemi dënime me nga 50 €. Për kohëzgjatje, sot në adresën time i pranova 3 vendime të

Gjykatës Themelore, pjesa që ka të bëjë me kundërvajtjen dhe i pezulloi 3 vendime që kanë qenë.

Armend Zemaj – Tha se nuk është problem inkasimi i mjeteve, por është dallimi për të njëjtën vepër, që po konsiderohet tash kundërvajtje, janë dënime të ndryshme. A keni pasur ndonjë bisedë me kryetarin e gjykatës? Problemi është në mes të fortëve, të cilët po dënohen më pak. Pse dënimet janë të ndryshme, kur akuzat janë të njëjta për mosdeklarim të pasurisë.

Hasan Preteni – Nuk mund të kërkojmë nga gjykatat që të kryejnë dënimet e njëjta, sepse janë të pavarura në veprime. Më vjen shumë keq për një rast që u përmend dhe që është tepër medial, i cili ka ndodhur në vitin 2008 dhe ne asnjë presion nuk kemi pasur nga askush. I vetmi problem ka qenë një sulm fizik, të cilin e kemi bërë të madhe dhe e kemi marrë policinë e sigurimit dhe nuk kemi pasur asnjë përkrahje prej askujt. Sa i përket pagave, drejtori e ka pagën e mirë, por të tjerët i kanë pagat e dobëta. Dy zyrtarët e mi e marrin pagën më pak se 500 €. Kapacitete të mjaftueshme kemi. Kemi formuar një divizion të veçantë për parandalimin e korrupsionit. Sa i përket shpëlarjes së parasë, është një njësi tjetër që e ka përgjegjësi. Është Njësi i Inteligjencës Financiare dhe për vërtetësinë e asaj se çka po deklarojmë, nuk kemi mundësi ta vërtetojmë atë. Secili prej nesh që nuk mund të arsyetojë pasurinë, ajo do t'i konfiskohet.

Albulena Haxhiu – Ju thoni se nuk ka bazë ligjore sa i përket konfliktit të interesit, ose ka kundërshtime në mes të ligjeve, mirëpo unë po e citoj vetëm këtë nen, në bazë të cilit është dënuar një person tjetër. Pra, anëtari i Bordit të Trustit, Ejup Qerimi, i cili ka qenë edhe drejtor ekzekutiv në PTK, është rast i njëjtë sikurse rasti i Betim Gjoshit në KQZ dhe anëtar i ndërmarrjes publike tregu. Për Ejup Qërimin ju keni thënë se është konflikt interesi, duke u bazuar në nenin në fjalë, është dashur që edhe Betim Gjoshi të deklarohet se cilën pozitë dëshiron ta mbajë, ndërsa i njëjti ka deklaruar se nuk merr pagë nga puna në KQZ, por dje tregoi se merr 353 € dhe benefite tjera, siç janë mbushjet dhe çka është më me rëndësi, merr pjesë në vendimmarrje në KQZ, dhe kjo z. Preteni, është konflikt interesi dhe duhet nisur procedurat për shkarkimin e tij. Sa i përket Sllobodan Petroviqit, ju këtë vendim e keni nxjerrë në shkurt të vitit 2013, ku tashmë ligji thotë se zyrtari i lartë nuk guxon të jetë në agjenci të pavarura, do të thotë se ju i keni nxjerrë vendimet në shpërpushje me atë që po thoni. Çështja tjetër është se ju po thoni se Ligji për konfiskim të pasurisë, nuk na lejon që të verifikohet më tutje pasuria. Pse atëherë ju si Agjenci nuk dolët me një deklaratë për media që ta kundërshtoni atë ligj dhe t'i bëni thirrje Qeverisë që mos ta miratojë atë ligj?

Armend Zemaj – Sa i përket kësaj çështjeje, a kemi të drejtë që të iniciojmë një hetim për këto që i tha Albulena, lidhur me rastin Gjoshi?

Hasan Preteni – Agjencia Kundër Korrupsionit është agjenci e pavarur, e cila realizon misionin konform ligjit. Asnjë vendim për konflikt interesi nuk është atakuar dhe deri më tani nuk është hedhur poshtë. E kemi publikuar tashmë rastin e fundit për prorektorin e universitetit, Sejdi

Rexhepi, që është në konflikt interesi dhe neve nuk na intereson se kush është dhe i cilës parti është.

Komisioni për Legjislacion, me 5 vota për dhe 3 kundër, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

Rekomandim

Të shqyrtohet dhe të miratohet raporti i punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2012.

4. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit

Kryetari– Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin për produktet e ndërtimit dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-181 për produktet e ndërtimit dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe për miratim.

5. Shqyrtimi i raportit me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë

Kryetari– Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL, në Projektligjin për treguesit gjeografikë dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen nëse kanë vërejtje.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-187 për treguesit gjeografikë dhe amendamentet e propozuara, nuk janë në mospajtim me Kushtetutën dhe ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji me amendamentet e propozuara, mund t'i procedohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Arben Gashi